



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-34238 dt. 02.02 2022

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 17.06.2022, ora 10:00.
Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 20.05.2022.
2. Propozim Vendim për Kornizën afatmesme bugjetore 2023-2025.
3. Propozim Vendim për plotësim ndryshimin e Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SHA në Drenas-Gllogoc.
4. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Gllogocit për periudhën, 2022-2030.
5. Raporti i zbatimit të Planit zhvillimor Komunal 2020-2028.
6. Raporti i auditimit të Komunës së Gllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31, dhjetor 2021.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës theksoi se kemi edhe një pikë shtesë për rendin e ditës: Raporti i auditimit të Komunës së Glllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31, dhjetor 2021, pasi që nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në mënyrë unanime të gjithë anëtarët e KPF-së.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur me dt. 20.05.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:
07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Propozim Vendim për Kornizën afatmesme buxhetore 2023-2025.**

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, dihet se buxheti i komunës së Drenasit përbëhet prej tri grandeve, grandit i qeverisë qendrore, grandit i të hyrave vetanake dhe grandit i performancës komunale grandit i donatorit, kjo është një formulë e përgjithshme për të gjitha komunat, që i përcaktoni kufijtë buxhetor për të gjitha komunat, 1 është numri i popullsisë, përmasat gjeografike, numri i popullsisë pakicë, për arsim përcaktohet në bazë të numrit të nxënësve dhe raportet nxënës mësimit, për shëndetësi vizita për kokë banori, shërbimet për kokë banori dhe kosto mesatare për vizitë. Nëse e shohim buxhetin e vitit 2021 në bazë të qarkores buxhetore e shohim se buxheti i vitit 2023 projeksioni i vitit 2022 dhe projektionet provuese për vitin 2024-2025 kemi një rritje të buxhetit nga vitet e kaluara, dhe buxheti për vitin 2023 parashihet të jetë 18,156,892 € ku grandit i përgjithshëm i administratës për vitin 2023 është 9,126,783, i arsimit me 6,564,735 €, dhe i shëndetësisë 2,456,374 €. Ne pas takimit që e kemi mbajt në bordin e drejtorëve të gjitha drejtoritë i kanë sjellë kërkesat buxhetore, e kemi rrit buxhetin për investime kapitale me shumë se sa qarkoren e parë buxhetore ku parashihet që investimet kapitale të marrin pjesë me 29 % ne e kemi 34.65 % është shkalla e investimeve kapitale ku ka shkuar në 6,335,649 € për vitin 2023 ndërsa për vitin 2024 me shumë prej 7,167,087 dhe për vitin 2025 me shumë prej 782,667 € kjo është në pika të shkurtra sa i përket kësaj pike të rendit të ditës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, i falënderoj asamblistët për pjesëmarrje gjatë dëgjimeve buxhetore, kërkoj nga asamblistët që me mbajt ndonjë takim me qytetar për dëgjime buxhetore jo vetëm me u njoft më afër me problemet e qytetareve por edhe se paku 3 pikë ia shtojmë grandit të performancës, do të bëjmë edhe staza të biçikletave sepse edhe aty i shtojmë piket, mirëpo për grand të performancës është e përcaktuar nëse asamblistët mbajnë dëgjime publike me qytetar, dhe duhet të mbajnë edhe procesverbale.

Drejtori i Financave-Shyqiri Bublaku, sa i përket dëgjimeve buxhetore të organizuar nga asambleistat duhet të kërkohet prej qytetareve gjegjësisht nga pjesëmarrësit që t'i caktojnë prioritetet, të cilat i kanë si fshat apo si lagje, dhe ato prioritetet të inkorporohen në buxhet.

Hamit Haxhiu- unë personalisht i kam mbajtur këto takime në fshatra me qytetar dhe kam mbajtur procesverbal mirëpo e kam mbajtur vetëm për vete pa ndonjë zyrtar të komunës duke marrë parasysh edhe kërkesat e qytetarëve dhe përfaqësuesve të lagjeve.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, për me fitu pikë ne kemi mbajtur dëgjime buxhetore dhe na kanë humbur piket që nuk kemi bërë proces, për këtë arsye duhet të mbajmë procesverbal kur të mbajmë takime me qytetar.

Hamit Haxhiu, pati një pyetje për drejtorin të tabelës dhe planit komunal të bashkëfinancimit të projektsh me ministrinë e linjës dhe donatorët, kërkoj një sqarim për ndërtimin e stadiumit faza e dytë?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, ne e kemi një kod buxhetor bashkë investim, ne e qesim një kod 5.000 € për me ruajt kodin për me mujt me marrë investim prej Ministrisë të caktuar sepse na kur nuk kemi kod nuk mundemi me hy bashkëfinancim, për stadionin “Rexhep Rexhepi” nuk është për stadionin nacional.

Pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi e hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për plotësim ndryshimit të Statutit Nr. 12-060/05-14928, të datës 30.04.2020, për Ndërmarrjen Publike Lokale “Stacioni i autobusëve” SHA në Drenas-Glllogoc.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 07 vota (**Për**), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Glllogocit për periudhën, 2022-2030.**

Drejtoresha për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Flutura Avdiu, harta zonale e Komunës së Drenasit ka filluar në vitin 2019 e hartimit të saj, ka shkruar një procedurë e gjatë derisa kemi arritur në finalizim, jemi pajisur me gjitha pëlqimet e Ministrisë dhe Mjedisit të Planifikimit Hapësinor dhe infrastrukturës ku me dt.10.06.2022 kemi pranuar edhe vendimin për dhënien e pëlqimit të hartës zonale të Komunës nga ministria e cila është pjesa finale e gjithë këtij procesi i cili ka filluar prej fillimit të bërjes prej hartimit e deri në finalizim të tij, me rastin e dhënies të pëlqimit për miratim të hartës zonale ne i propozojmë Kuvendit të Komunës që të miratohet ky propozim vendim, që të miratohet harta zonale e Komunës së Glllogocit për periudhën tetë vjeçare 2022-2030, harta zonale e Komunës së Glllogocit është një dokument multisektorial i cili përmes grafikoneve fotografive hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masave të veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe në projeksionet e arritshme publike dhe private të teritorit të Komunës së Drenasit. Me Hartën Zonale të komunës shfuqizohen planet rregulluese urbane në fuqi që kanë qenë qendra I-II-III dhe për tetë vjet ky dokument i planifikimit zbatohet në gjithë teritorin e Komunës së Drenasit. Me Hartën zonale do të fillojnë ndërtimet të mesme të ulëta si dhe të larta në këtë qytet.

Arbër Halilaj, pas një punë të gjatë ashtu siç e cekim edhe drejtoresha është finalizuar drafti final i hartës zonale të komunës sonë, që bashkë me planin zhvillimor të komunës janë dy dokumente më të rëndësishme për një komunë, unë natyrisht jam i lumtur që është arritur deri në këtë pikë dhe në parim jam për që Drenasi të ketë hartën zonale, duke pasqyruar sa puna përgatitore dëgjime me qytetar, aktivitete tjera, duke marrë për bazë që kjo ka filluar para tri viteve dhe ne jemi legjistraturë e re unë jam që kjo pikë të del në asamble në seancën e radhës jo në këtë seancë për një arsye që të kemi një raport gjithëpërfshirës nga gjithë kjo punë voluminoze dhe ky aktivitet derisa ka ardhur në finalizim i draftit, të informohemi ne si asamble me të gjitha këto aktivitete, me sugjerimet e qytetareve kërkesat e tyre sa ato kërkesa dhe sugjerime janë inkuorpuar në hartën zonale të komunës sepse kur të votojmë diçka kaq të rëndësishëm duam të jemi sa më të informuar, nuk jam kundër por duhet të kemi më shumë informacion raportim rreth gjitha punëve parapërgatitore edhe aktivitetet tjera që e kanë sjellë deri të draftit final.

Hamit Haxhiu, unë jam për Hartën Zonale, mirëpo nuk kemi asnjë raport ose ndonjë proces rreth hartës zonale, edhe unë kërkoj me u shty për seancë të radhës që të kemi material shtesë dhe të jemi më të informuar rreth kësaj pikë.

Besart Bajrami, zyrtar në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, harta zonale ka filluar bashku me planin zhvillimor komunal, plani zhvillimor 2008-2020 nuk ka qenë i zbatueshëm, kur është bërë vlerësimi i tij në vitin 2018 ka dalë më pak se 40 % i zbatueshëm, me vendim të kuvendit për fillimin e procedurave të planit zhvillimor komunal edhe të HZK-së kemi nisur, plani zhvillimor komunal është dokument strategjik më i madh dhe pas hartimit të HZK-së që është dokument më teknik, për gjitha këto kemi mbajtur dëgjime publike me qytetar, kemi mbajtur edhe diskutimin publik raportin e shqyrtimit publik debat publik në sallë të kuvendit edhe në fund është hartuar një raport të cilin e kemi përcjellur edhe në ministri të cilin ua sjellim edhe juve.

Hamit Kastrati, harta zonale a përfshinë edhe zonat komasacionit apo vetëm zonat tjera, edhe qas mundemi ne si komunë me iu dhënë leje atyre që kanë ndërtuar në zonë komostative

Florentina Elezi-Veliu, e pashë se kish shumë ndërtime pa leje çka do të ndodhë, qysh keni me iu qas këtyre ndërtimeve pa leje, do të jetë shumë problem për me dalë në praktik kjo.

Besart Bajrami, zyrtar në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, qysh nga fillimi i hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor të planit zhvillimor komunal ne e kemi vërejtur se janë 1300 objekte të cilat janë të ndërtuara mbi tokën e komasacionit për këtë arsye ne i kemi thirrë përfaqësuesit e ministrisë së bujqësisë që janë përgjegjës për edhe për implementimin e tokës bujqësore por edhe për ruajtjen e tokës bujqësore edhe përfaqësuesit Ministrisë së Planifikimit Hapësinor mirëpo kemi ardhur në përfundim se duhet t'i zbatojnë ligjet të cilat kanë qenë dhe janë prapë në fuqi që është ligji i komasacionit, ligji mbi tokën bujqësore, dhe ne si komunë nuk kemi mujt me planifikuar në nivel më të lartë se sa na takon, ne u dashtë prapë me i paraqit ato si zona bujqësore qysh e kanë edhe destinimin me ligj dhe realisht nuk kemi mundur të bëjmë asgjë me tokën bujqësore për ndërrim të destinimit, edhe në PZHK edhe në hartë zonale këto janë prapë si tokë bujqësore ku nuk lejohet ndërtimi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari, nga 2018 toka nuk ka ndryshu ka mbetur tokë bujqësore, çka do të ndodhë për periudhën 2022-2030 me ndërtimet të cilat janë bërë më toka bujqësore, a i trajton ligji i legalizimit ato?

Hamit Kastrati, me ato ndërtimet që janë bërë në tokën me komasacion çka do të bëhet tash e tutje?

Besart Bajrami, zyrtar në Drejtorinë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, ligji i legalizimit është një ligj i cili u miratua më vonë dhe është mbi ligjin e ndërtimit dhe mbi ligjin e planifikimit dmth të gjitha objektet të cilat janë të ndërtuara para datës 05 shtator 2018 atyre ju ka bërë një zgjidhje, zgjidhja e parë është nëse e ka çështjen pronësore të rregulluar dhe është tok ndërtimore ajo legalizohet i jepet certifikata edhe është gjithçka në rregull, ndërsa sa i përket çështjes se komasacionit dhe ata pronarë që i kanë ndërtimet e tyre në toka ku nuk mundën me e zgjidhë çështjen në pronësi atëherë këta hyn në listë të pritjes.

Pas diskutime vërejtje që u dhanë kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 03 vota (**Për**), 2 kundër, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: 5 Raporti i zbatimit të Planit zhvillimor Komunal 2020-2028.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime të gjithë anëtarët e KPF-së e rekomanduan për kuvend këtë pikë të rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. Raporti i auditimit të Komunës së Glllogocit për vitin financiar të përfunduar më 31,dhjetor 2021.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime të gjithë anëtarët e KPF-së e rekomanduan për kuvend këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: 8. Të ndryshme

Pasi nuk pati diskutime të tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:15 min .

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milaim Hajdari